

KONTRATE
PER THEMELIMIN E SHOQERISE ANONIME “TELEVIZION KUKESI”

Neni 1
Aksioneret

Aksioneret e shoqerise “**TELEVIZION KUKESI**” SH.A. jane:

1. Lutfi Mecka, i biri i Ismailit, i datelindjes 1959, banues ne Kukes,
2. Shyqeri Duraku, i biri i Alushit, i datelindjes 1954, banues ne Tirane,
3. Zef Çupi, i biri i Prenges, i datelindjes 1958, banues ne Tirane,

Neni 2
Emertimi

Emertimi i shoqerise do te jete “**TELEVIZION KUKESI**”.SH.A.

Neni 3
Selia

Shoqeria e ka seline (qendren administrative) ne qytetin e Kukesit

Neni 4
Kapitali

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 2.000.000 leke. Ky kapital esht i ndare ne 2.000 aksione, secili me vlere nominale 1.000 (njemije) lek.

Pronesia e aksioneve per secilin aksioner themelues i shoqerise eshte:

1. Lutfi Meçka zoteron 33,33% te kapitalit ose 666,6 aksione
2. Shyqeri Duraku zoteron 33,33% te kapitalit ose 666,6 aksione
3. Zef Çupi zoteron 33,33% te kapitalit ose 666,6 aksione

Neni 5
Objekti

Objekti i shoqerise eshte:

Transmetim televizion kombetar.

Neni 6
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe per 20 vjet, duke filluar nga data e marrjes se vendimit per regjistrimin e saj ne Gjykate.

Neni 7

Struktura

Shoqëria do të ketë organet e saj që janë:

1. Asambleja e Aksionereve
2. Këshilli Mbikqyres
3. Drejtoria

Rregullat e funksionimit të tyre parashikohen në Statutin e shoqërisë dhe pranohen nga aksioneret.

Kryetar i Këshillit Mbikqyres është z.Baudin Murati .

Drejtor është zoti Lutfi Mecka

Neni 8

Kontrata

Hartimi i Kontrates bëhet në 4(katër) ekzemplare origjinale, në gjuhën shqipe dhe me vlerë të barabartë.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Organi i zgjidhjeve të mosmarreveshjeve, kur ato nuk zgjidhen me mirekuptim, do të jetë Gjykata.

Neni 10

Hyrja në fuqi


Kjo Kontratë, që nga aksioneret gjendet në pajtim me vullnetin e tyre, do të hyjë në fuqi sot në ditën e nënshkrimit të saj me

Aksioneret themelues

Lutfi Mecka

Shyqeri Duraku

Zef Çupi



STATUTI
I
SHOQERISE "TELEVIZION KUKESI" SH.A.

Ne mbeshtetje te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare , aprovohet ky Statut i shoqerise anonime pa oferte publike "TELEVIZION KUKESI" SH.A.

Neni 1:
Forma

Midis themeluesve te shoqerise qe jane pronare te aksioneve eshte krijuar shoqeria anonime qe rregullohet nga ligjet ne fuqi dhe nga ky statut.

Neni 2:
Objekti i veprimtarise.

Shoqeria ka kete objekt:
Transmetim televizion kombetar.

Neni 3:
Emertimi.

Emertimi i shoqerise eshte "TELEVIZION KUKESI" SH.A.
Ne te gjitha aktet dhe dokumentet qe dalin nga shoqeria emertimi i saj do te ndiqet menjehere nga inicialet "SH.A." dhe nga shpallja e kapitalit themeltar te saj.

Neni 4:
Vendndodhja e selise

Selia e shoqerise eshte ne Kukes
Selia mund te transferohet ne cdo vend tjeter ne territorin e Republikes se Shqiperise me nje vendim te Asamblese se Aksionereve.

Neni 5:
Kohezgjatja

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj per 20 vjet.

Shkurtimi i kesaj kohezgjatjeje ne rastin e nje prishjeje te pershpjtuar te shoqerise behet me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve.

Neni 6:
Kontributet dhe kapitali themeltar.

Ne momentin e themelimit te shoqerise jane sjelle si kontribut ne para nje shume prej 2.000.000 leke. Ky kapital esht i ndare ne 2.000 aksione, secili me vlere nominale 1.000 (njemije) lek.

Pronesia e aksioneve per secilin aksioner themelues i shoqerise eshte:

1. Lutfi Meçka zoteron 33,33% te kapitalit ose 666,6 aksione
2. Shyqeri Duraku zoteron 33,33% te kapitalit ose 666,6 aksione
3. Zef Çupi zoteron 33,33% te kapitalit ose 666,6 aksione

Kontributet ne para te aksionereve themelues te shoqerise, qe u pergjigjen vleres nominale te aksioneve qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise, jane nenshkruar dhe shlyer plotesisht prej tyre.

Shuma e kapitalit themeltar e derdhur nga aksioneret eshte depozituar rregullisht ne nje llogari te hapur ne banke ose te noteri. Derdhjet jane vertetuar nga nje certifikate e hartuar sipas ligjit.

Neni 7:

Zmadhimi i kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar i shoqerise mund te zmadhohet sipas modaliteteve dhe menyrave te parashikuara ne nenet 150 deri 163 te ligjit "Per shoqerite tregtare".

Organi kompetent qe vendos per zmadhimin e kapitalit eshte Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve.

Kapitali i shoqerise mund te zvogelohet. Ne te gjitha rastet zvogelimi i kapitalit behet ne te njejten mase ne perpjestim me vleren e aksioneve qe zoterojne. Organi kompetent qe vendos per zvogelimin e kapitalit themeltar eshte Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve.

Neni 8:

Transferimi dhe shitja e aksioneve.

Aksionet e shoqerise jane te transferueshme.

Transferimi i pronesis se aksioneve nominative behet mbasi te jete marre miratimi me shkrim nga Asambleja e zakonshme.

Perparesia ne transferimin e aksioneve iu takon aksionereve te tjere te shoqerise, sipas radhes se paraqitjes se ofertave, te cilat vleresohen nga Keshilli Mbikqyres.

Aksionet mund t'i transferohen cdo personi fizik e juridik, shqiptar ose i huaj, drejtorise duhet t'i paraqitet nje kerkese ku percaktohet identiteti i personit qe i transferohet pronesia, numri i aksioneve qe parashikon transferimi i pronesis dhe cmimi i ofruar.

Neni 9:

Te drejtat dhe detyrat e lidhura me aksionet

Cdo aksioner i jep zoteruesit te tij te drejten e marrjes te nje pjese nga fitimet e shoqerise ne perpjestim me kuoten-pjese te kapitalit qe ai perfaqeson.

Pronesia e nje aksioni permban te drejten e plote te aderimit ne asamblene e aksionereve Pervec ketyre, aksioni i jep zoteruesit te tij te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne kushtet e parashikuara nga ligji ose te caktuara ne kete Statut.

Aksioneret jane pergjegjes materialisht deri ne kufirin e vleres nominale te aksioneve qe zoterojne.

Te drejatat dhe detyrimet e lidhura me aksionet e ndjekin ate ne cfaredo forme qe transferohet nga njera dore ne tjetren.

Aksionet jane te pandashme kundrejt shoqerise. Bashkpronaret e aksioneve paraqiten ne shoqeri nepermjet perfaqesuesit te caktuar prej tyre.

Neni 10:

E drejta e personit juridik dhe dokumentacioni.

Shoqeria "TELEVIZION KUKESI" SH.A. fiton te drejten e personit juridik qe nga dita e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane.

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentat per krijimin e saj, Statutin dhe Kontraten per Themelim.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 11:

Organet

Organet drejtuese dhe administruese te shoqerise jane:

- * Asambleja e aksionereve, e zakonshme dhe e jashtezakonshme,
- * Keshilli Mbikqyres
- * Drejtoria
- * Keshilli Operativ e Teknik

Shoqeria mund te krijojte, ne kushtet e parashikuara nga ligji dhe ky Statut, Zyra Perfaqesie. Dege, si dhe mund te marri pjese ne cfaredo menyre ne shoqeri te tjera.

Neni 12:

Rregulla te perbashketa per mbledhjen e Asamblese

A) Natyra e Asamblese dhe karakteri i detyrueshem i vendimeve

Asamblete e aksionereve cilesohen te zakonshme ose te jashtezakonshme sipas natyres se vendimeve per te cilet ato jane thirrur qe te marrin. Cdo Asamble perfaqeson teresine e aksionereve me te drejte vote. Vendimet e Asamblese detyrojne te gjithe aksioneret. pavaresisht ne votojne kunder apo mungojne.

B) Thirrja dhe vendi i mbledhjes se Asamblese

Asamble e aksionereve thirren nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres, nga jo me pak se dy anetare ose 1/4 e anetareve te ketij Keshilli ose nga Drejtori dhe sipas parashikimit te bere ne nenin 132 te ligjit nr 7638 dt.19.11.1992

Asamblete mblidhen ne seline e shoqerise ose ne cdo vend tjeter te treguar ne thirrjen qe i dergohet cdo aksioneri 15 dite perpara mbledhjes e qe permban dhe rendin e dites.

C) Pjesmarrja e perfaqesimi ne Asamble

Cdo aksioner ka te drejte te asistojë ne mbledhjet e Asamblese dhe te marre pjese ne vendimet e saj, personalisht ose nepermjet nje perfaqesuesi te pajisur me mandat te posacem e ne kushtet e parashikuara nga ligji.

Ç) Drejtimi i mbledhjes dhe proces-verbalet

mbledhjet e Asamblese drejtohen nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres ose, ne mungese te tij, nga anetar i Keshillit i caktuar nga Kryetari. Drejtuesi i mbledhjes cakton edhe nje sekretar (qe mund te mos jete aksioner) per te mbajtur proces-verbalin. Proces-verbali, pervec te tjerave permban edhe:

- * daten dhe vendin e mbledhjes,
- * numrin e aksionereve te pranishem dhe quorumin e arritur,
- * drejtuesin e mbledhjes,
- * rendin e dites,
- * dokumentat e raportet qe jane diskutuar
- * nje permbledhje te debateve
- * rezultatet e votimeve

Proces-verbalet e mbledhjeve ruhen ne seline e shoqerise

D) Quorumi dhe votimi

Ne Asamblete quorumi llogaritet per teresine e aksioneve qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise. E drejta e votes qe u perket aksioneve eshte perpjestimore me kapitalin qe ato perfaqesojne. Cdo aksioner i jep zoteruesit te drejten e nje vote. Votimi kryhet i vecante per cdo ceshtje apo vendim.

DH) Venia e dokumentave ne dispozicion te aksionereve

Shoqeria mban dhe ve ne dispozicion te aksionereve, ne kushtet dhe afatet e parashikuara me ligj, dokumentet e llogarite vjetore qe shqyrton Asambleja.

Neni 13:

Asambleja e zakonshme

Asambleja e zakonshme mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda 6 muajve qe pasojne mbylljen e vitit financiar. Ajo merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem kur aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne jo me pak se 2/3 te aksioneve me te drejte vote. Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem ose perfaqesuar. Vendimet e asamblese se zakonshme mund te jene edhe qarkullues.

Asambleja e zakonshme merr cdo vendim qe nuk sjell ndryshimin e statutit te shoqerise. Ajo ka keto kompetenca:

- * miraton politiken e pergjithshme (strategjine afatgjate te zhvillimit te shoqerise)
- * miraton plan-biznesin dhe planin financiar vjetor
- * miraton, ndryshon dhe hedh poshte llogarite vjetore qe jane shtruar per miratim.
- * vendos per shperndarjen e fitimit dhe destinimin e rezultatit ekonomik ne pajtim me ligjet dhe Statutin,
- * emerone dhe shkarkon antaret e Keshillit Mbikqyres si dhe cakton shperblimet e parashikuara ne Statut per ta,
- * miraton ose jo emerimet e antareve te Keshillit Mbikqyres te bera nga vete ky keshill si emerime te perkoheshme,
- * miraton pjesemarrjen ne siper marrje te tjera, brenda ose jashte vendit,
- * ratifikon ose jo ndryshimin e selise se shoqerise,

emeron Ekspertin (ose Ekspertet Kontabel) te autorizuar dhe vendos per raportin e paraqitur prej tyre lidhur me amrrevshjet qe i nenshtrohen autorizimit paraprak te keshillit mbikqyres.

Neni 14: Asambleja e jashtezakonshme

Asambleja e jashtezakonshme mblidhet me kerkesen e Kryetarit te Keshillit Mbikqyres, ose jo me pak se dy anetare te ketij keshilli, ose te aksionereve qe zoterojne jo me pak se 1/4 e aksioneve te shoqerise.

Asambleja e jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare kur akioneret e pranishem ne mbledhje zoterojne jo me pak se 2/3 e aksioneve me te drejte vote, kurse ne mbledhjen e dyte ky quorum eshte jo me pak se 1/2 e aksioneve me te drejte vote.

Vendimet e Asamblese se jashtezakonshme merren me shumicen prej 3/4 te votave qe u perkasin aksionereve te pranishem.

Asambleja e jashtezakonshme ka keto kompetenca:

- * te ndryshoje Statutin e Shoqerise
- * te vendose zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit ne baze te procedurave te parashikuara ne ligj dhe raportit te paraqitur nga Keshilli mbikqyres.
- * te vendose per prishjen (ose shperndarjen) e shoqerise ne rast te humbjeve te konstatuara sipas kushteve dhe procedurave te parashikuara ne ligj.
- * te heqe te drejten e perparesise se nenshkrimit te aksioneve, neqoftese e cmon te arsyeshme ne rastin e zmadhimit te kapitalit.
- * te ndryshoje kompetencat e keshillit Mbikqyres dhe te Drejtorise

Mbledhjet e Asamblese se jashtezakonshme verbalizohen dhe materialet ruhen ne arkivin e shoqerise.

Neni 15: Keshilli Mbikqyres

Keshilli Mbikqyres zgjidhet nga Asambleja e zakonshme e shoqerise ne cdo 3 vjet. Ai perbehet nga tre anetare, njeri prej te cileve eshte Kryetar. Ata jane:

Baudin Murati, i biri i Mahmutit, i dtl 21.4.1951, lindur ne Shishtavec , banues ne Kukes .
Sefer Saramati, i biri i Avdyilit, i dtl 20.8.1944, lindur ne Prizren , banues ne Prizren ,
Halim Bakalli, i biri i Qazimit, i dtl 20.10.1962, lindur ne Kukes , banues ne Tirane ,

Te gjithe anetaret e Keshillit Mbikqyres jane aksionere te shoqerise (ose duhet te behen te tille brenda nje viti nga dita e zgjedhjes).

Anetaret e Keshillit Mbikqyres jane te rizgjedhshem. Ata mund te revokohen nga Asambleja e zakonshme vetem per shkaqe te perligjura.

Antaret e Keshillit Mbikqyres jane persona fizike ose juridike, qe nuk duhet te jene te punesuar ne shoqeri. Ne rastin kur nje antar i Keshillit Mbikqyres eshte nje person juridik, ai duhet te caktoje nje perfaqesues te perhershem

Nese nje ose disa vende te antareve te Keshillit Mbikqyres mbeten bosh per shkak vdekje, shkarkimi ose doreheqje, zevendesimi i tyre behet jo me vone se tre muaj. Anetari i emeruar ne zevendesim te nje antari tjeter, perfundon mandatin e paraardhesit.

Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres behen me thirrjen e Kryetarit sa here qe e kerkon interesi i shoqerise dhe te pakten nje here ne tre muaj. Mbledhjet mbahen ne seline e shoqerise dhe rendi i dites caktohet nga Kryetari.

Cdo antar i Keshillit Mbikqyres mund t'i jape mandat nje antari tjeter per ta perfaqesuar ne nje mbledhje te Keshillit.

Shqyrtimet dhe vendimet e Keshillit Mbikqyres jane te vlefshme kur numri i antareve te pranishem ne mbledhje eshte jo me pak se gjysma e antareve ne funksion.

Vendimet merren me shumicen e votave te antareve te pranishem dhe te perfaqesuar. Ne rast votash te barabarta ajo e kryetarit eshte percaktuese (Ne rastin e zgjedhjes ose shkarkimit te Drejtorit te shoqerise kerkohet edhe vota e kryetarit te Keshillit Mbikqyres)

Shqyrtimet dhe vendimet e Keshillit Mbikqyres evidencohen me proces-verbale, qe nenshkruhen nga drejtuesi i mbledhjes dhe ruhen ne arkivin e shoqerise.

Vendimet e Keshillit Mbikqyres mund te jene edhe qarkulluese. Per te realizuar kete lloj vendimi, shperndahet projekti, mblidhen verejtjet dhe me pas firmoset vendimi perfundimtar pa u mbledhur antaret fizikisht ne ndonje salle.

Keshilli Mbikqyres ka vulen e vet.

Keshilli Mbikqyres ka keto kompetenca:

- * ushtron kontrollin e perhershem te drejtimit dhe administrimit te shoqerise nga na e Administrates se saj,
- * miraton strukturen organizative te shoqerise dhe ndryshimet e saj, kriteret e punesimit dhe te pagave, si dhe rregulloren e brendshme te shoqerise,
- * autorizon dhenien e dorezanive dhe garancive,
- * autorizon kryerjen e investimeve tej atyre te parashikuara ne programin financiar vjetor,
- * autorizon hapjen e veprimtarive ose degeve te reja, shkrirjen, bashkimin ose mbylljen (teresisht a pjeserisht) te veprimtarive dje degeve te shoqerise,
- * autorizon pjesemarrjen ne shoqeri te tjera,
- * autorizon shitjen dhe shkembimin e pasurive qe perbejne aktive te qendrueshem te shoqerise.
- * autorizon negocvimin, perfundimin apo ndryshimin e cdo kontrateje me afat ose per nje shume mbi dymilione leke ose ekuivalente ne valute (kufiri i kesaj shume caktohet per cdo vit),
- * kryhen te gjitha verifikimet qe cmon te nevojshme dhe ka te drejte te kerkoje te njihet me dokumentet e duhura per permbushjen e detyrave te tij (kurse ne cdo tre mujor nje raport te paraqitur nga Drejtori i),
- * miraton bilancin vjetor e ia paraqet Asamblese se zakonshme,

- *miraton praktikat e marketingut,
- * miraton strukturen e tarifave baze te sherbimeve,
- * therret dhe drejton mbledhjet e Asamblese,
- * disponon per transferimin e selise se shoqerise,
- * zgjedh Drejtorin e (edhe drejtore te tjere) me votat e te pakten tre antareve te Keshillit Mbikqyres, nje nga te cilet duhet te jete Kryetari i Keshillit.

Neni 16: Drejtoria

Drejtoria perbehet nga nje antar .

Drejtori emerohet per nje periudhe tre vjecare. Ai mund te shkarkohet para afatit per paaftesi profesionale, ose per shkak te gjendjes shendetesore te semure qe e ben te paaft per plotesimin e detyres. ose per gabime te renda ne drejtimin e shoqerise.

Drejtori nuk mund te bejne pjese ne Keshillin Mbikqyres te shoqerise, por mund te jete aksionere ne te.

Menyra dhe masa e shperblimit te Drejtorit caktohet nga Keshilli Mbikqyres qysh me aktin e emerimit.

Drejtori eshte pergjegjes per drejtimin dhe mire funksionimin e shoqerise, si dhe per administrimin e pasurise se saj. Ai zbaton metodat dhe menyrat qe i cmon me te mira e me te pershtatshme per te realizuar detyrat e percaktuara nga Asambleja e Keshillit Mbikqyres.

Drejtori ka kompetenca te plota per te vepruar ne cdo rrethane ne emer te shoqerise, por kufizohet nga ato kompetenca qe ligji dhe ky Statut ua ka dhene shprehimisht Keshillit Mbikqyres dhe Asamblese se Aksionereve.

Drejtori ushtron kompetencat e veta brenda objektit te shoqerise. Ne marredhenie me te tretet ai perfaqeson shoqerine, e cila merr persiper detyrimet nga aktet apo vendimet e perfunduara prej tij, kur keto jane te lidhura me objektin e shoqerise.

Te gjitha aktet dhe vendimet e Drejtorit firmosen, vulosen, protokollohen dhe ruhen ne arkiv. Drejtori perdor vulen e shoqerise.

Drejtori ka keto kompetenca:

- *propozon vendime e akte te tjera per keshillin Mbikqyres ose Asamblene e aksionereve.
- * kerkon thirrjen e Asamblese se Pergjithshme kur Keshilli Mbikqyres i refuzon autorizimin per nje operacion qe i lypset ky autorizim (sic jane operacionet qe parashikohen ne nenin 15 te ketij Statuti).
- * emerone dhe shkarkon Shefat e Sektoreve dhe personelin tjeter administrativ, si dhe percakton menyren dhe pagat e tyre.
- * miraton kontraten-tip te punes dhe kontraten-tip me abonentet,
- * merr vendime per marredheniet financiae brenda shoqerise dhe me personat e trete jashte saj.
- * merr vendime per zgjidhjet teknike te rrjetit,
- * autorizon shperblimet e vecanta e honoraret per punonjes te vecante te shoqerise ose persona te tjere jashte saj.

Ne cdo rast Drejtori eshte i detyruar qe, per veprimtarine e tij ne pergjithesi ose per probleme te vecanta, te raportoje ne Asamblene e aksionereve (kur kete e kerkojne aksionere qe

zoterojne jo me pak se 1/5 e kapitalit te shoqerise) dhe ne Keshillin Mbikqyres (kur kete e kerkojne Kryetari ose jo me pak se tre antare te ketij keshilli).

Drejtori ndihmohet ne aktivitetin e tij nga Keshilli Operativ e Teknik.

Drejtori ka te drejte te delegoje pjese te kompetencave te tij.

Neni 17:

Keshilli Operativ - Teknik

Keshilli Operativ - Teknik eshte organ konsultativ i Drejtorit ne te cilin marrin pjese ky i fundit me cilesine e Kryetarit dhe keshilltaret e Shefat e sektoreve, me cilesine e antareve.

Keshilli Operativ - Teknik mblidhet me kerkesen e Drejtorit ose te jo me pak se dy antareve te tij.

Keshilli Operativ-Teknik nuk merr vendime, por i ben propozime Drejtorit ne lidhje me problemet e drejtimit dhe administrimit te shoqerise, koordinimit te punes midis sektoreve, si dhe problemet e shfrytezimit te rrjetit ose te zgjerimit te tij.

Propozimet e ketij Keshilli miratohen me shumice votash.

Per antaret e Keshillit Operativ-Teknik nuk parashikohet shperblim i vecante, pervec rasteve kur ata ngarkohen per te kryer studime e per te hartuar projekte qe tejkalojne detyrat e punes normale te tyre.

Neni 18:

Marreveshjet e ndaluara dhe marreveshjet qe kerkojne autorizim

Antaret e Keshillit Mbikqyres dhe te Drejtorise u ndaloher te kontraktojne qe te marrin hua nga shoqeria, t'u akordohet llogari rrjedhese ose ne nje forme tjeter, dhe te bejne shoqerine dorezenese apo garante per detyrimet e tyre ndaj te treteve.

Cdo marreveshje ndermjet shoqerise dhe njerit nga antaret e Keshillit Mbikqyres ose Drejtorise qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi (me ndermjetesim), duhet te autorizohet paraprakisht nga Keshilli Mbikqyres (nga Kryetari, apo jo me pak se tre antare te ketij Keshilli).

KONTABILITETI DHE FINANCAT E SHOQERISE

Neni 19:

Aftesia paguese

Shoqeria krijon marzhin e aftesise paguese te mjaftueshme per veprimtarine e saj, duke perfshire te gjitha vleren e pasurive, si kapitalin themeltar, rezervat, fitimet e mbartura, etj.

Neni 20:

Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te cdo viti. Perjashtimisht ushtrimi i pare financiar perfshin kohen nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar deri me 31 dhjetor.

Neni 21 **Bilanci vjetor**

Shoqeria qe do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe veprimtarise se saj, ne pajtim me kerkesat e ligjit. Per ndjekjen e gjendjes financiare Drejtori , sipas struktures dhe permbajtjes te percaktuara ne planin kontabel, pergatit raportin mbi gjendjen financiare cdo tremujor si dhe ate vjetor.

Ne mbylljen e cdo viti financiar hartohet inventari i pasurise dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat ligjore per kontabilitetin, si dhe raporti vjetor mbi gjendjen financiare te shoqerise gjate ushtrimit te kaluar, ku parashikohen dhe ndryshime per te ardhmen e veprimtarite e tjera te shoqerise.

Keto dokumenta i jepen ekspertit kontabel nje muaj perpara mbledhjes se Asamblese se aksionereve, i cili ben komentet e veta ne nje raport te vecante.

Neni 22 **Miratimi i bilancit.**

Raporti per gjendjen financiare te shoqerise, i detajuar per te gjitha operacionet dhe per gjendjen e administrimit te shoqerise paraqitet nga Drejtori ne fund te vitit financiar ne Keshillin Mbikqyres, i cili e miraton dhe ia paraqet Asamblese se zakonshme te aksionereve.

Neni 23: **Rezultati i ushtrimit financiar dhe rezervat**

Rezultati i ushtrimit financiar percaktohet si diference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit, duke perfshire ne keto te fundit edhe amortizimet, provizionet dhe taksat.

Nga fitimet e ushtrimit, te pakesuara kur eshte rasti me humbjet e meparshme, hiqet te pakten 5% per te krijuar rezerven e domosdoshme. Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme pushon se qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin 15% te kapitalit themeltar.

Asambleja e zakonshme ne rast nevojje mund te formoje edhe fonde te tjera. Shuma e fitimeve te mbetura pas krijimit te rezervave si me siper, perfaqeson dividendin.

Aksioneret kane te drejte te marrin pjesen e fitimit te destinuar per ndarje nga Asambleja e zakonshme, proporcionalisht me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 24 **Pergjegjesite ndaj Shtetit**

Shoqeria ka llogarite e saj bankare dhe pergjigjet me fondet e saj per taksat dhe detyrimet e tjera ndaj Shtetit.

Neni 25: Ekspertet kontabel

Kontrolli financiar ushtrohet nga nje ose disa eksperte te autorizuar, te licensuar konform legjislacionit shqiptar, te cilet emerohen nga Asambleja e zakonshme dhe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin Ekspert kontabel i autorizuar i shoqerise eshte **z. Marie Dushi**.

Ekspertet kontabel jane te autorizuar qe ne cdo kohe te vitit se bashku ose vec e vec te bejne te gjitha verifikimet e kontrollet qe gjykojne te domosdoshme dhe mund te shfrytezojne te gjitha dokumentacionin e vleresuar si te dobishem ne ushtrimin e funksionit te tyre. ne vecanti, kontratat, librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe regjistrat e proces-verbaleve.

Detyrat dhe te drejtat e eksperteve kontabel te pavarur te shoqerise jane ato te parashikuara nga ligji "Per shoqerite tregtare".

Ekspertet kontabel informojne Keshillin Mbikqyres dhe Drejtorin per:

- * kontrollet, verifikimet dhe sondazhet qe kane kryer,
- * pjeset e bilancit dhe te dokumentave te tjera te kontabilitetit ku ata kane verejtje.
- * parregullsitet dhe pasaktesitet qe kane zbuluar.

Ekspertet kontabel thirren ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres kur mbyllen llogarite e vitit financiar si dhe ne mbledhjen e Asamblese. Ata jane pergjegjes si ndaj shoqerise, ashtu edhe ndaj te treteve per pasojat qe rrjedhin per fajin e nenvlefesimin e tyre gjate ushtrimit te funksioneve qe kane.

Honoraret e eksperteve i ngarkohen shoqerise. Keshilli Mbikqyres, me rastin e miratimit te eksperteve, miraton dhe masen e shperblimit te tyre.

Marredheniet e eksperteve kontabel me shoqerine percaktohen ne nje kontrate midis tyre dhe Drejtorit .

Neni 26 Likuidimi

Shperndarja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe, kur per shkaqe te ndryshme nuk mund te vazhdoje aktivitetin e saj. Ne kete rast ajo vihet ne likuidim.

Likuidimi behet ne pajtim me dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare" e te ligjit "Per proceduren e falimentimit".

Asambleja e jashtezakonshme e aksionereve cakton likuidatoret duke percaktuar edhe kompetencat qe ata kane.

RREGULLIMI I SHOQERISE

Neni 27: Ndryshimet e kapitalit themeltar

Ndryshimet e kapitalit themeltar, zmadhimi ose zvogelimi i tij, si dhe menyra e realizimit te tyre, do te percaktohen konforme dispozitave te ligjit nr. 7638 date 19.11.1993 "Per shoqerite tregtare" dhe te akteve te tjera ligjore ne fuqi.

Neni 28:

Transformimi ne shoqeri me oferte publike.

Shoqeria pa oferte publike mund te transformohet ne shoqeri anonime me oferte publike. Vendimi per kete transformim merret nga Asambleja e jashtezakonshme e aksionereve.

Neni 29:

E drejta e komunikimit dhe e informimit.

Cdo aksioner ka te drejten e komunikimit e te informimit te vazhdueshem.

Para mbledhjes se cdo Asambleje ose konsulte, cdo aksioner ka te drejten e njohjes se dokumentacionit e te informacioneve te tjera qe lidhen me problemet qe do te diskutohen ose konsultohen. Keto duhet t'i vihen ne dispozicion aksionerit ne kushtet e percaktuara ne dispozitat ligjore dhe rregulloret ne fuqi.

Neni 30:

Fshehtesia e informacionit

Te gjitha aksioneret, antaret e Keshillit Mbikqyres, drejtoret dhe te punesuarit e tjere pergjigjen per pasojat e demshme qe i shkaktohen shoqerise nga perhapja e paaautorizuar e informacionit.

Neni 31:

Marredheniet me punonjesit.

Marredheniet e shoqerise me punonjesit rregullohen sipas legjislacionit mbi marredheniet e punes ne Republiken e Shqiperise.

Neni 32:

Falimentimi, paaftesia ose vdekja e nje aksioneri.

Shoqeria nuk prishet kur falimenton, vdes ose shfaq paaftesi fizike apo mendore njeri nga aksioneret.

Neni 33:

Vula dhe logoja.

Shoqeria ka vulen e vet, te rrumbullaket ne qender te te ciles vendoset logoja qe permban emrin e shoqerise dhe adresen e selise se saj.

Cdo dege (ose Filial) dhe Perfaqesi ka gjithashtu vulen e vet me specifikimet perkatese dhe te ndryshme nga ajo e shoqerise.

Neni 34:

Mosmarreveshjet.

Per mosmarreveshjet midis aksionereve, te punesuarve dhe personave te trete, ne rast se zgjidhja nuk arrihet me mirekuptim (konsensus), ajo behet objekt i gjykates kompetente.

Neni 35:

Rastet e paparashikuara.

Rastet e paparashikuara ne kete Statut do te trajtohen sipas parashikimeve te ligjit nr 7638, date 19.11.1993 "Per shoqerite tregtare" dhe akteve te tjera ligjore ne fuqi.

Neni 36:

Gjuha, kopjet origjinale dhe nenshkrimi i statutit.

Ky statut eshte hartuar ne kater kopje, ne gjuhen shqipe dhe me vlere te barabarte.

Hartuesit e ketij Statuti e gjejne ne pajtim me vullnetin e tyre dhe e nenshkruan rregullisht ne Tirane sot me daten .

AKSIONERET THEMELUES

LUTFI MEÇKA SHYQERI DURAKU ZEF ÇUPI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr 879 Rep
Nr 156 Kol

Tirane, me 05.06. 2000

VERTETIM

Sot, ne Tirane, ne daten 05.06. 2000 (dymije), perpara meje Noterit, u paraqiten personalisht z. Lutfi Mecka, i biri i Ismailit, i datelindjes 1959, banues ne Kukes, me numur pasaporte 0020199, z. Shyqeri Duraku, i biri i Alushit, i datelindjes 1954, banues ne Tirane, me numur pasaporte 0608763 dhe z. Zef Çupi, i biri i Prenges, i datelindjes 1958, banues ne Tirane, me numur pasaporte 1438044, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar te cilet deklaruan se Kontraten dhe Statutin e themelimit te shoqerise e kane hartuar me vullnetin e tyre te lire te plote, e nenshkuani rregullisht para meje dhe une noteri e vertetoj sipas ligjit.



NOTERI

Hadrihe Bejani